URDHËR
Nr. 183/5, datë 14.6.2021

PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË URDHRIN NR. 633, DATË 17.11.2020, "PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri nr. 2435, datë 27.5.2021,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 633, datë 17.11.2020, "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura", të ndryshuar, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrit, hiqet togfjalëshi "apo të hapura, konferencat" .

2. Pas pikës 1, shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2 me përmbajtje si vijon:

"1/1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 50 persona në vende të hapura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore nga data 15.6.2021 deri në datën 28.6.2021. Grumbullimet sipas kësaj pike të respektojnë masat e distancimit social dhe protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

1/2. Lejohen konferencat me kapacitet të reduktuar deri në 30% të pjesëmarrësve dhe në zbatim të protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik nga datë 1.7.2021. ".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu